



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.491/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Fejzullah Rexhepi kryesues, Faton Ademi dhe Zyhdi Haziri anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Fitore Isufi, duke vendosur përkitazi me ankesat e Shefit të Komisionit për ankesa, Arben Shala, nga subjekti politik PDK, me seli në Prishtinë, dega në Prizren, paraqitur kundër: Artan Abrashi, bartës i listës së votuesve, nga subjekti politik LVV, Adem Shabanaj, kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal në Prizren dhe Besart Osmani, kandidat për zanëtarë të Kuvendit Komunal në Prizren, nga subjekti politik LDK, për shkak të parregullsive në ditën e votimit, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 24.10.2017, mori këtë:

#### V E N D I M

**REFUZOHEN** si të pabazuara ankesat e Arben Shala, Shef i Komisionit për Ankesa, nga subjekti politik PDK, me seli në Prishtinë, dega në Prizren të cilat identifikohen me shenjë ZL.Anr.491/2017, ZL.A.nr.492/2017 dhe ZL.A.nr.493/2017 të datës 24.10.2017, të parashtruara kundër Artan Abrashi, bartës i listës së votuesve, nga subjekti politik LVV, Adem Shabanaj, kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal në Prizren, nga subjekti politik LVV dhe Besart Osmani, kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal në Prizren, nga subjekti politik LDK, për shkak të parregullsive në ditën e votimit, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017

#### A r s y e t i m

Me datën 24.10.2017, PZAP-i ka pranuar tri ankesa nga Arben Shala, shef i komisionit për ankesa, nga subjekti politik PDK, me seli në Prishtinë, dega në Prizren, me të cilat pretendon se Besart Osmani në Shkollën e Mesme të Ulët "Ibrahim Fehmiu", në Prizren, Artan Abrashi në Shkollën e Mesme të Ulët "Lek Dukagjini" në Prizren, dhe Adem Shabanaj në Shkollën e Mesme Teknike "11Marsi" në Prizren, kanë bërë presion tek votuesit. Me këtë rast është bërë shkelje e rregullave zgjedhore.

Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur fotografi, lidhur me rastet në fjalë.

Paneli, në bazë të nenit 8.3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, ka bashkuar ankesat e lartcekura dhe i trajton si një ankesë evidentuar me ZL.Anr.491/2017, për shkak të natyrës së njëjtë të rasteve dhe pretendimeve dhe për të dy ankesat i vendosi me një vendim për shkak të efikasitetit dhe ekonomizimit të procedurës .

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 2 të LZP-së, gjeti se:

#### **Ankesat janë të pa bazuara**

Pretendimet ankimore të parashtruesit të ankesës Arben Shala, lidhur me shkeljet e pretenduar të parregullsive në ditën e zgjedhjeve, Paneli i vlerësoj si të pabazuara dhe si të

tilla i refuzoj për arsye se nga fotografitë e ofruara si dëshmi nuk mund të vërtetohen pretendimet e ankuesit.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lartë, e në kuptim të nenit 117 dhe 118 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
ZL. Anr.491/2017 më datën 24.10.2017.



**Kryesuesi i Panelit**  
**Fejzullah Rexhepi**

**Këshillë juridike:** *Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.*